

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 19-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuele**  
**mbajtur më 15.6.2023**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës Kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lllazar Trajçev, Zoran Fidanoski .

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional:** mr. Dragica Ljubevska, Maja Damevska, Ivona Mufisheva, Goran Radunoviq, Aleksandar Xhuvarevqi, Emilija Janevska.

**Të pranishmit e tjerë : /**

Z. Petrushevski hapi seancën e 19-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt në hapësirat e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratim i Propozim-Procesverbalit nga vazhdimi i parë i seancës së 17-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 1.6.2023.
2. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 3-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 1.6.2023.
3. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 18-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 1.6.2023.
4. Propozim-vendim për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit radiodifuziv jofitimprurës në nivel rajonal në komunën e Shkupit.
5. Propozim-vendim për refuzimin e Aplikacionit për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit transmetues jofitimprurës në nivel lokal për Komunën e Tetovës.
6. Propozim-vendim për konkursin e përealizuar publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit jofitimprurës radiodifuziv në nivel lokal për komunën e Tetovës.
7. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të SHTR ALSAT-M SHPK Shkup për shkelje të nenit 53 paragrafi (2) të LSHMAAV.
8. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të SHTR TELEVISION MAKPETROL SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 55 paragrafët (5), (6) dhe (7) të LSHMAAV.
9. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të SHTR RADIO PRO-FM SHPKNJP Gostivar për shkelje të nenit 15 paragrafi (5) të Ligjit për Media .

10. Propozim për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtje të ueb faqeve të Agjencisë .
11. Të ndryshme.

### **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e propozuar nga vazhdimi i pari i seancës së 17-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 1.6.2023, me tekstin e propozuar.

### **Pika 2**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 3-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 1.6.2023, me tekstin e propozuar.

### **Pika 3**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 18-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 1.6.2023, me tekstin e propozuar.

### **Pika 4**

Z. Trajçevski shpjegoi propozimin për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit jofitimprurës radiodifuziv në nivel rajonal në komunën e Shkupit. Ai ka sqaruar se në seancën e 9-të të Këshillit të Agjencisë është marrë Vendim për shpalljen e konkursit për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor për institucionin jofitimprurës radiodifuziv, destinuar për popullatën studentore. Ai informoi se në konkursin, i cili zgjati 60 ditë, është paraqitur vetëm një kandidat, institucioni privat i arsimit të lartë "Universiteti i Shkupit". Sektorët kompetente të Agjencisë konstatuan se kandidati i plotëson kushtet e parapara në konkurs dhe për këtë arsye i propozojnë Këshillit që këtij subjekti jofitimprurës t'i japë leje për transmetim në radio dhe shtoi se duke pasur parasysh faktin se është subjekt jofitimprurës, nuk do të priset konkurrenca dhe funksionimi financiar i radiostacioneve të tjera rajonale në Shkup.

Këshilli i Agjencisë njëzëri e miratoi Propozimin dhe miratoi Vendim për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit jofitimprurës radiodifuziv, destinuar për popullatën studentore, në gjuhën maqedonase, në nivel rajonal, zona e shpërndarjes D1 Crn Vrv - zonë në nivel rajonal Shkup (qyteti i Shkupit dhe komunat Çuçer Sandevë, Haraçinë, Ilinden, Petrovec, Zelenikovë, Studeniçan dhe Sopishtë) te personi juridik Institucioni i arsimit të lartë privat "Universiteti i Shkupit" - Shkup, me seli në bul. "Partizanski odredi" nr. 99, 1000 Shkup, e cila do të transmetohet nëpërmjet radiofrekuencës së përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike e RMV-së, përkatësisht: 106,5 MHz.

Obligohet Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit të Agjencisë, vendimin e mësipërm ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb faqen e Agjencisë.

Obligohet Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike, vendimin për dhënie të lejes t'ia dorëzojë institucionit privat të arsimit të lartë "Universiteti i Shkupit" - Shkup, me seli në bul. "Partizanski odredi" nr.99,1000 Shkup,me qëllim të regjistrojë institucionin jofitimprurës

radiodifuziv në regjistrin përkatës, në mënyrë që brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së regjistrimit, Agjencia të lëshojë lejen në fjalë.

#### **Pika 5**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për refuzimin e Kërkesës për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit jofitimprurës radiodifuziv në nivel lokal në rajonin e komunës së Tetovës. Ai shpjegoi se në seancën e 9-të të Këshillit të Agjencisë është marrë vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit jofitimprurës radiodifuziv në nivel lokal, në zonën e rajonit të Tetovës, në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Ai informoi se në konkurs ka aplikuar vetëm një kandidat, universiteti shtetëror nga Tetova, por pas vlerësimit të ofertës është konstatuar se nuk i plotëson kushtet e parapara në konkurs dhe për këtë arsye propozohet të merret Vendim për refuzim të kërkesës për pjesëmarrje në konkursin publik për dhënie të lejes.

Këshilli i Agjencisë njëzëri e miratoi propozimin dhe mori Vendim me të cilin refuzon Kërkesën për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënien e lejes për institucionin jofitimprurës radiodifuziv për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal të komunës së Tetovës, e servisit programor në nivel lokal në zonën e komunës së Tetovës, i dorëzuar nga Universiteti i Tetovës-RMV, Tetovë, PA1 nr. 08-192, datë 17.5.2023, për faktin se nuk plotëson kushtet e përcaktuara në Vendimin për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit jofitimprurës radiodifuziv në nivel lokal, PA1 nr.08-98, datë 9.3.2023.

Obligohet Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit Vendimin ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

#### **Pika 6**

Z. Lazo Petrushevski theksoi se kjo pikë ka të bëjë me atë të mëparshme, pasi që kërkesa për pjesëmarrje në konkursin publik është refuzuar, më pas është e nevojshme të merret Vendim për konkurs publik të pasuksesshëm për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit jofitimprurës radiodifuziv në nivel lokal, në rajonin e Tetovës.

Z. Fidanoski shprehu keqardhjen e sinqertë për faktin se universiteti shtetëror në Tetovë nuk ka arritur të kompletojë procedurën për të pasur konkurs të suksesshëm dhe për të marrë lejen e punës për radio jofitimprurëse në territorin e Komunës së Tetovës. Ai përkujtoi se kjo është hera e tretë që universiteti shtetëror nga Tetova konkurron. Ai tha se pikës së mëparshme i është dhënë leja, në bazë të dokumentacionit të plotësuar me sukses, dhe interesimit dhe ambicjes nga universiteti në Shkup. Ai është i sigurt se të njëjtën ambicie kanë edhe në Universitetin e Tetovës, beson se ka ndonjë ndërprerje në realizimin për të shkuar si duhet procedura, ndoshta nuk janë konsultuar sa duhet me shërbimin në Agjenci dhe shpreson që do të shfaqin sërish interes, se do të ketë bashkëpunim të plotë me shërbimin dhe se do të ndihmohen me çdo mënyrë që ta përfundojnë me sukses historinë e tyre.

Z. Ajdini shprehu keqardhjen që për herë të tretë Universiteti Shtetëror në Tetovë nuk e plotësoi siç duhet dokumentacionin.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi propozimin dhe miratoi Vendim për konkurs publik të pasuksesshëm për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit jofitimprurës radiodifuziv të destinuar për popullatën studentore, në nivel lokal, në

zonës e komunës së Tetovës, në gjuhën shqipe dhe maqedonase, e cila do të transmetohet nëpërmjet radiofrekuencës së përcaktuar nga Agjencia për Komunikim Elektronik të RMV-së, përkatësisht: 107.2 MHz, publikuar në bazë të Vendimit për publikimin e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit jofitimprurës radiodifuziv në nivel lokal, PA1 nr.08-98 datë 9.3.2023. ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 55/23) për faktin se brenda afatit të caktuar për dorëzimin e aplikacioneve, pas konkursit në fjalë, respektivisht më datë 15.5.2023 në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, nuk është pranuar asnjë aplikacion i vetëm që i plotëson kushtet e përcaktuara në konkurs.

Obligohet Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit të Agjencisë që vendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

### **Pika 7**

Udhëheqësja Janevska ka shpjeguar Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR ALSAT-M SHPK Shkup për shkelje të nenit 53 paragrafi (2) të LSHMAAV. Ajo ka shpjeguar se shkelja tek TV ALSAT-M është konstatuar me mbikëqyrjen e rregullt e kryer në maj 2023. Është shkelur neni 53 paragrafi (2) nga LSHMAAV, respektivisht janë transmetuar komunikime komerciale audiovizuale të fshehta. Në emisionin informativ "Pasqyra e Shëndetit"(Ogledallë na zdravjeto) që është emision me tematikë të specializuar për fushën e shëndetësisë, ku përmes një bashkëbisedimi me themeluesin dhe drejtorin e spitalit "Sveti Vid", i cili përmes deklaratave (shtojcave) në të cilat pacientët thonë fjalë lavdëruese për mjekët dhe spitalin, është bërë reklamë prezantimi i spitalit, pra emisioni përmban komunikime të fshehta komerciale audiovizuale. Për transmetuesin propozohet masë paralajmërim publik, me afat të harmonizimit të veprimtarisë menjëherë pas pranimi të Vendimit për shqiptimin e masës dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për respektimin e dispozitës, për të parë nëse transmetuesi do të veprojë sipas paralajmërimit. Për ndryshe, transmetuesi ka dorëzuar deklaratë me shkrim, e cila është pjesë e materialeve, në të cilën thonë se kanë kryer inspektim në regjistrimin e emisionit dhe kanë konstatuar se kanë tejkualuar dispozitat e Ligjit dhe se menjëherë kanë ndërmarrë masa për të parandaluar shkelje të tilla dhe që të mos përsëriten.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim nr.10-2216/1 datë 23.5.2023 për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore dhe njëzëri konkludoi ndaj SHTR ALSAT-M SHPK Shkup t'i shqipton masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 53 paragrafi (2) nga LSHMAAV, sepse më 8 maj 2023, në reprizën e emisionit informativ " Pasqyra e Shëndetit" (Ogledallo na zdravjeto),emision i specializuar shëndetësor, ka transmetuar komunikime të fshehta komerciale audiovizuale për Spitalin "Sveti vid".

Në pajtim me pikën 4 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, ndaj SHTR ALSAT-M SHPK Shkup, obligohet menjëherë pas pranimi të Vendimit të harmonizon veprimtarinë e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Obligohet Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike që të përpilojë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj transmetuesit në fjalë.

Obligohet Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (në tërësi, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Obligohet Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit që Aktvendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

### **Pika 8**

Udhëheqësja Janevska e shpjegoi propozimin për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj SHTR TELEVISION MAKPETROL SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 55 paragrafët (5), (6) dhe (7) të LSHMAAV. Ajo shpjegoi se shkelja e Televizionit Telma është konstatuar me këtë mbikëqyrje të rregullt të kryer në maj të vitit 2023. Ata kanë shkelur dispozitat e nenit 55 paragrafët (5), (6) dhe (7) të LSHMAAV, respektivisht bëhet fjalë për rregullat për vendosjen (plasimin) e produkteve në programe. Shkelja u konstatua në dy edicione të emisionit argëtues-dokumentar "Aventurat e Markut"(Aventurite na Mark) dhe në një edicion të emisionit edukativo-argëtues " Garden club Gradini ". Në edicionet e emisionit argëtues-dokumentar "Aventurat e Markut" rekomandohen posaçërisht për promovim restorantet "Staro Zlatno bure" dhe "Çorbaxhiski an", ndërsa në emisionin " Garden Club Gardens " në një rubrikë "Mjete praktike"(Praktični allati) është bërë një shtojcë tre minutëshe, që paraqet prezantim të detajuar komercial të dy veglave të kopshtarisë nga kompania *Nakayama*. Për këto arsye, sugjerohet që transmetuesit t'i shqiptohet masë paralajmërim publik me afat për harmonizim prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të kontrolluar nëse do të veprojë sipas masës së shqiptuar. Dhe televizioni Telma ka dërguar njoftim. Në njoftim thuhet se për shkeljen janë përgjegjës partnerët afarist që kanë regjuar (prodhuar) emisionet dhe se kanë kërkuar atkëmbimi nga personat përgjegjës dhe të autorizuar të partnerëve afarist që i prodhojnë këto edicione të emisionit dhe si shtojcë të deklaratës së tyre janë shtuar dhe atkëmbimet (korrespondencë) që i kanë dërguar producentët e këtyre dy emisioneve. Në deklaratë, thuhet se mediumi do të ndërmarrë të gjitha masat për të parandaluar shkelje të tilla të ligjit në të ardhmen.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim nr. 10-2215/1 datë 23.5.2023 për mbikëqyrje të rregullt të kryer programore dhe njëzëri konstatoi ndaj SHTR Televizija Makpetrol SHPKNJP Shkup, t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 55 paragrafët (5), (6) dhe (7) nga LSHMAAV, sepse më 8 maj 2023, dy edicionet e emisionit argëtues-dokumentar "Aventurat e Markut" nuk u shënuan me sinjalizim për program që përmban vendosjen (plasimin) e produkteve dhe shërbimet e rekomanduara në mënyrë specifike nga restoranti "Staro/Zlatno bure" dhe produktet nga kompania *Saša tartufi* , ndërsa edicioni i emisionit edukativo-argëtues " Garden club Gardens " ishte shënuar në mënyrë të papërshtatshme me sinjalistikën e përkrahur për program që përmbante vendosjen (plasimin) e produkteve dhe promovonte në mënyrë të veçantë produktet *Nakayama*.

Në pajtim me pikën 4 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr. 01-01-4139/1 datë 7.11.2022, Televizioni SHTR Makpetrol SHPKNJP Shkup është urdhëruar në afat prej 20 ditësh nga pranimi i Aktvendimit të harmonizon veprimtarinë e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale .

Obligohet Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përpilon Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj transmetuesit në fjalë.

Obligohet Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, që të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (në tërësi, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Obligohet Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit që Aktvendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

#### **Pika 9**

Udhëheqësja Janevska ka shpjeguar propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR RADIO PRO-FM SHPKNJP Gostivar për shkelje të nenit 15 paragrafit (5) të Ligjit për Media. Ajo sqaroi se bëhet fjalë për obligimin e mediave që deri më 31 mars të këtij viti të dorëzojnë Raport në Agjenci për përmbushjen e obligimeve nga koncepti programor dhe të lejes për transmetim. Transmetuesi PRO-FM nuk e ka bërë këtë në afatin e paraparë dhe deri në kohën e përgatitjes së Raportit. Për këto arsye, sugjerohet që transmetuesit t'i shqiptohet masë paralajmërim, me afat plotësues prej 45 ditësh për të dorëzuar Raportin siç kërkohet në Ligjin për Media. Ajo shpjegoi se masa e radhës është heqja e lejes.

Z. Petrushevski sugjeroi që transmetuesit t'i shpjegojë me kujdes dhe nëpërmjet telefonit të informohet për situatën.

Udhëheqësja Janevska sqaroi se kolegët disa herë kanë kontaktuar (biseduar) me transmetuesin, ndërkohë që ka pasur dhe ndryshim në strukturën e pronësisë së radios dhe mendon se ka problem në komunikimin ndërmjet pronarit të mëparshëm dhe atij të ri të medias.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim nr. 10-1941/1 datë 27.4.2023 për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative dhe njëzëri konkludoi ndaj SHTR RADIO PRO-FM SHPKNJP Gostivar, që t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 5 paragrafi (5) të Ligji për Media, për mosdorëzimin e raportit me shkrim për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen për transmetim në radio .

Në pajtim me pikën 15 paragrafi (6) të Ligjit për media dhe pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masë nr. 01-01-4139/1 datë 7.11.2022, të SHTR Radio PRO-FM SHPKNJP Gostivar, udhëzohet që në afat prej 45 ditësh nga pranimi i aktvendimit ta harmonizon veprimtarinë e tij me dispozitat e Ligjit për media.

Obligohet Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike që të përpilojë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtjes publike ndaj transmetuesit në fjalë.

Obligohet Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (në tërësi, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Obligohet Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit që Aktvendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

#### **Pika 10**

Udhëheqësi Xhuvareviq ka shpjeguar Propozimin për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtje të ueb faqeve të Agjencisë. Ai shpjegoi se bëhet fjalë për furnizim njëvjeçarë, me vlerë të parashikuar prej 80.000,00 denarë, e cila është e nevojshme për funksionimin normal të ueb faqeve të Agjencisë, si dhe për optimizimin e serverit VDS .

Z. Petrushevski pyeti nëse vlera e parashikuar është e njëjtë me vitet e kaluara apo është rritur pak? Duke pasur parasysh se të gjitha shpenzimet e jetesës janë rritur.

Udhëheqësi Xhuvareviq është përgjigjur se kontrata e fundit ka qenë për dy vjet, pasi që ky furnizim është për një vit, vlera është zvogëluar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën e radhës të furnizimit publik : mirëmbajtje të ueb faqeve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën shërbim: mirëmbajtja e ueb faqeve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për një periudhë 1 (një) vjeçare është paraparë dhe është në përputhje me Planin Vjetor për Furnizime publike për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4766/1 datë 23.12.2022, dhe mjetet (fondet) sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023.

### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Nr. 02-2414/9**

**27.06.2023**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,**

---

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**